



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 648/2 Prot.

Gramsh, më 10.03.2022

V E N D I M

Nr. 27, datë 28.02.2022

MBI

MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANEVE TËMBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE
KULLOTAVE PËR BASHKINË GRAMSH.

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, në mbështetje të ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni 11, bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndyshuar neni 3 (gërma "ç"), neni 8 (pika 2), neni 9 (pika 1.1/ b), neni 23 (pika 4), neni 54 gërma "k", neni 55 (pika 2 dhe 6), bazuar në ligjin nr.107/2014, datë 31.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", të ligjit nr.115/2014, datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Vendimit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", të ndryshuar, Këshilli Bashkiak Gramsh :

V E N D O S I :

- 1.Të miratojë planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për Bashkinë Gramsh për 5(pesë) ekonomitë pyjore "Dushku i Bulçarit", "Gramsh-Vinë", "Holtë-Lukovë", "Rove" dhe "Vidhan-Skëndërbegas".
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor,Bujqësisë,Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Gramsh.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë nga data e shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh.Gjini
Pranoi: G.Lena
Miratoi: G.Lena
Dosja nr: _____

KRYETARI I KËSHILLIT
GRETA LENA

